FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 89 — 31 korrik — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 70/2012 datë 28.6.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e rregulloreve teknike globale për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen ose të përdoren tek automjetet me rrota	4945
Ligj nr. 71/2012 datë 28.6.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar	4958
Ligj nr. 72/2012 datë 28.6.2012	Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë	4959
Akt normativ i KM nr.2, datë 25.7.2012	Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare	4971
Vendim i KM nr. 445, datë 11.7.2012	Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi	4973

LIGJ
Nr. 70/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR VENDOSJEN E RREGULLOREVE TEKNIKE GLOBALE PËR AUTOMJETET ME RROTA, PAJISJET DHE PJESËT QË MUND TË INSTALOHEN OSE TË PËRDOREN TEK AUTOMJETET ME RROTA

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara për vendosjen e rregulloreve teknike globale për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen ose të përdoren tek automjetet me rrota, bërë në Gjenevë më 25 qershor 1998.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.6.2012

Shpallur me dekretin nr.7719, datë 20.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NË LIDHJE ME VENDOSJEN E RREGULLOREVE TEKNIKE GLOBALE PËR AUTOMJETET ME RROTA, PAJISJET DHE PJESËT QË MUND TË INSTALOHEN OSE PËRDOREN TEK AUTOMJETET ME RROTA

Preambulë
Bërë në Gjenevë më 25 qershor 1998
Kombet e Bashkuar 1998

Palët kontraktuese,

Duke vendosur miratimin e një Marrëveshjeje për të vendosur një proces nxitjeje të zhvillimit të rregulloreve teknike globale që sigurojnë nivele të larta sigurie, mbrojtjen e ambientit, efikasitetin e energjisë dhe cilësinë kundër vjedhjes së automjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve që mund të instalohen dhe/ose të përdoren tek automjetet me rrota;

Duke vendosur që një proces i tillë nxit, gjithashtu, harmonizimin e rregulloreve teknike ekzistuese, duke njohur të drejtën e autoriteteve lokale, kombëtare dhe rajonale për të miratuar dhe mbajtur rregullore teknike në sferat e shëndetit, mbrojtjes së ambientit, efikasitetit të energjisë dhe cilësinë kundër vjedhjes që janë më rigoroze se ato që vendosen në nivel global;

Duke pasur autorizimin për të lidhur një marrëveshje të tillë sipas paragrafit 1(a) të termave të referencës të UN/ECE dhe kapitullit XIII të rregullave procedurale të UN/ECE, rregulli 50;

Duke njohur që kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e një pale kontraktuese sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ekzistuese mbi shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen e ambientit;

Duke njohur që kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e një pale kontraktuese sipas marrëveshjeve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), duke përfshirë marrëveshjen për barrierat teknike të tregtisë (BTT) dhe me synimin e vendosjes së rregulloreve teknike sipas kësaj marrëveshjeje, si një bazë për rregullimin e tyre teknik në një mënyrë që është në pajtim me këto marrëveshje;

Me synimin që palët kontraktuese në këtë marrëveshje të përdorin rregulloret teknike globale të vendosura sipas kësaj marrëveshjeje si një bazë për rregulloren e tyre teknike;

Duke njohur rëndësinë për shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien të përmirësimit të vazhdueshëm dhe kërkimit të niveleve të larta të sigurisë, mbrojtjes së ambientit, efikasitetit të energjisë dhe cilësinë kundër vjedhjes të mjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve që mund të instalohen dhe/ose përdoren te mjetet me rrota, dhe vlerën potenciale për tregtinë ndërkombëtare, zgjidhjen e konsumatorit dhe ofrimin e produktit të konvergjencave në rritje në rregulloret teknike ekzistuese dhe të ardhshme dhe standardet e tyre përkatëse;

Duke njohur që qeveritë kanë të drejtën të kërkojnë dhe zbatojnë përmirësimet në nivelin e shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes së ambientit dhe të përcaktojnë nëse rregulloret teknike globale të vendosura sipas kësaj marrëveshjeje janë të përshtatshme për nevojat e tyre;

Duke njohur punën e rëndësishme për harmonizimin e kryer tashmë sipas marrëveshjes së vitit 1958;

Duke njohur interesin dhe ekspertizën në rajone të ndryshme gjeografike në lidhje me sigurinë, problemet mjedisore të energjisë dhe kundër vjedhjes dhe metodat për zgjidhjen e këtyre problemeve, dhe vlerën e atij interesi dhe ekspertize në zhvillimin e rregulloreve teknike globale për të ndihmuar në arritjen e atyre përmirësimeve dhe minimizimin e divergjencave;

Me dëshirën për të nxitur miratimin e rregulloreve të vendosura teknike globale në vendet në zhvillim, duke marrë parasysh çështjet dhe rrethanat e veçanta për ato vende dhe veçanërisht ata që janë më pak të zhvilluar;

Me dëshirën që rregulloreve teknike të zbatuara nga palët kontraktuese t'u jepet konsiderata e duhur nëpërmjet procedurave transparente në zhvillimin e rregulloreve teknike globale dhe që kjo konsideratë të përfshijë analizë krahasuese të përfitimeve dhe efektivitetit të kostos;

Duke njohur që vendosja e rregulloreve teknike globale që ofrojnë nivele të larta të mbrojtjes do të inkurajojnë vende të veçanta të nxjerrin përfundimin që ato rregullore do të ofrojnë mbrojtjen dhe rezultatin që nevojitet brenda juridiksionit të tyre;

Duke njohur ndikimin e cilësisë së karburanteve të automjeteve në realizimin e kontrolleve mjedisore të automjeteve, shëndetin njerëzor dhe efikasitetin e karburantit; dhe

Duke njohur që përdorimi i procedurave transparente është i një rëndësie të veçantë në zhvillimin e rregulloreve teknike globale sipas kësaj marrëveshjeje dhe që ky proces zhvillimi duhet të jetë në përputhje me proceset rregullatore të zhvillimit të palëve kontraktuese të kësaj marrëveshjeje,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

1.1.1 Vendosja e një procesi global nëpërmjet të cilit palët kontraktuese nga të gjitha rajonet e botës mund të zhvillojnë së bashku rregullore teknike globale në lidhje me sigurinë, mbrojtjen e ambientit, efikasitetin e energjisë dhe cilësinë kundër vjedhjes të mjeteve me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren te mjetet me rrota;

1.1.2 Të sigurohet që, në zhvillimin e rregulloreve teknike globale, t'u jepet konsiderata e duhur dhe objektive rregulloreve teknike ekzistuese në palët kontraktuese dhe rregulloreve të UN/ECE-së;

1.1.3 Të sigurohet që t'i kushtohet konsideratë objektive analizës së teknologjisë më të mirë të ofruar, përfitimeve përkatëse dhe efektivitetit të kostos sipas rastit në zhvillimin e rregulloreve teknike globale;

1.1.4 Të sigurohet që procedurat e përdorura për zhvillimin e rregulloreve teknike janë transparente;

1.1.5 Të arrihen nivele të larta të sigurisë, mbrojtjes së ambientit, efikasitetit të energjisë dhe cilësisë kundër vjedhjes brenda komunitetit global dhe të sigurohet që veprimet sipas kësaj marrëveshjeje nuk nxisin ose rezultojnë në uljen e këtyre niveleve brenda juridiksionit të palëve kontraktuese, duke përfshirë nivelin lokal;

1.1.6 Të ulen barrierat teknike ndaj tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet harmonizimit të rregulloreve ekzistuese teknike të palëve kontraktuese dhe rregulloreve UN/ECE, dhe zhvillimit të rregulloreve teknike globale të reja që rregullojnë sigurinë, mbrojtjen mjedisore, efikasitetin e energjisë dhe cilësinë kundër vjedhjes së mjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve që mund të instalohen dhe/ose përdoren në mjetet me rrota, në pajtim me nivelet e larta të sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore dhe qëllime të tjera të sipërpërmendura; dhe

1.1.7 Të sigurohet që, nëse nevojiten nivele alternative të rigorozitetit për të lehtësuar aktivitetet rregullatore në vende të caktuara, veçanërisht në vendet në zhvillim, këto nevoja të merren në konsideratë në zhvillimin dhe vendosjen e rregulloreve teknike globale.

1.2 Kjo marrëveshje duhet të operojë paralelisht me marrëveshjen e vitit 1958, pa cenuar autonominë institucionale të asnjë marrëveshjeje.

Neni 2

Palët kontraktuese dhe statusi konsultativ

2.1 Vendet që janë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën (UN/ECE), organizatat rajonale të integrimit ekonomik që themelohen nga vendet anëtare të ECE-s dhe vendet që janë pranuar në ECE në një cilësi konsultative në pajtim me paragrafin 8 të termave të referencës ECE, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë marrëveshje.

2.2 Vendet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe që marrin pjesë në aktivitete të caktuara të ECE-s në pajtim me paragrafin 11 të termave të referencës së ECE-s dhe organizatat rajonale të integrimit ekonomik të themeluara nga këto vende mund të bëhen palë kontraktuese në këtë marrëveshje.

2.3 Çdo agjenci e specializuar dhe çdo organizatë, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare, të cilave u është dhënë statusi nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, mund të marrin pjesë në atë cilësi në bisedimet e çdo pale pune gjatë shqyrtimit të çdo çështjeje me rëndësi të veçantë për atë agjenci ose organizatë.

Neni 3

Komiteti Ekzekutiv

3.1 Përfaqësuesit e palëve kontraktuese formojnë Komitetin Ekzekutiv të kësaj marrëveshjeje dhe mblidhen në atë cilësi të paktën një herë në vit.

3.2 Rregullat procedurale të Komitetit Ekzekutiv përcaktohen në aneksin B të kësaj marrëveshjeje.

3.3 Komiteti Ekzekutiv:

3.3.1 është përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë caktimin e prioriteteve për aktivitetin sipas kësaj marrëveshjeje;

3.3.2 shqyrton të gjitha rekomandimet dhe raportet nga palët e punës në lidhje me vendosjen e rregulloreve teknike globale sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

3.3.3 përmbush ato funksione të tjera që mund të jenë të përshtatshme sipas kësaj marrëveshjeje.

3.4 Komiteti Ekzekutiv ka përgjegjësinë përfundimtare për të vendosur nëse do të rendisë rregulloret në përmbledhjen e rregulloreve teknike globale kandidate dhe të vendosë rregullore teknike globale sipas kësaj marrëveshjeje.

3.5 Komiteti Ekzekutiv, në përmbushje të funksioneve të tij, përdor informacionin nga të gjitha burimet përkatëse nëse Komiteti e mendon të përshtatshme ta bëjë këtë.

Neni 4

Kriteret për rregulloret teknike

4.1 Për t'u renditur sipas nenit 5 ose vendosur sipas nenit 6, një rregullore teknike përmbush kriteret e mëposhtme:

4.1.1 Të japë një përshkrim të qartë të mjeteve me rrota, pajisjeve dhe/ose pjesëve që mund të instalohen dhe/ose përdoren te mjetet me rrota dhe që i nënshtrohen rregullores.

4.1.2 Të përmbajë kërkesa që:

4.1.2.1 sigurojnë nivele të larta të sigurisë, mbrojtjes mjedisore, efikasitetit të energjisë ose të cilësisë kundër vjedhjes; dhe

4.1.2.2 sipas rastit, shprehen në kuptimin e rendimentit në vend të karakteristikave të projektimit.

4.1.3 Përfshijnë:

4.1.3.1 Metodën e testit nëpërmjet të cilës demonstrohet përputhshmëria me rregulloren;

4.1.3.2 Për rregulloret që përfshihen sipas nenit 5, sipas rastit, një përshkrim të qartë të shenjave të aprovimit ose certifikimit dhe/ose etiketat që kërkohen për aprovimin tip dhe përputhshmërinë e prodhimit ose për kërkesat e vetëcertifikimit të prodhuesit; dhe

4.1.3.3 Sipas rastit, një periudhë paraprake minimale të rekomanduar kohe, bazuar mbi shqyrtimin e arsyetimit dhe praktikave, që një palë kontraktuese duhet të sigurojë para se të kërkojë përputhshmërinë.

4.2 Një rregullore teknike globale mund të përcaktojë nivele alternative joglobale të rigorozitetit ose rendimentit dhe procedurat e përshtatshme të testit, nëse është e nevojshme të lehtësohen aktivitetet rregullatore të vendeve të ndryshme, në vende të caktuara në zhvillim.

Neni 5

Përmbledhje e rregulloreve teknike globale të kandidatëve

5.1 Krijohet dhe mbahet një përmbledhje e rregulloreve teknike të palëve kontraktuese të ndryshme nga rregulloret UN/ECE që janë kandidatë për harmonizimin ose miratimin e rregulloreve teknike globale (që njihen si përmbledhje e kandidatëve).

5.2 Renditja e rregulloreve teknike në përmbledhjen e kandidatëve

Çdo palë kontraktuese mund të paraqesë një kërkesë te Komiteti Ekzekutiv për renditjen në përmbledhjen e kandidatëve të çdo rregulloreje teknike që kjo palë kontraktuese ka zbatuar, po zbaton ose ka miratuar për zbatim në të ardhmen.

5.2.1 Kërkesa e specifikuar në paragrafin 5.2 përmban:

5.2.1.1 Një kopje të kësaj rregulloreje;

5.2.1.2 Çdo dokumentacion të mundshëm teknik që mbështet këtë rregullore, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me teknologjinë më të mirë të mundshme, përfitimet përkatëse dhe efektivitetin e kostos; dhe

5.2.1.3 identifikimin e çdo standardi të njohur përkatës ekzistues ose të afërt ndërkombëtar vullnetar.

5.2.2 Komiteti Ekzekutiv shqyrton të gjitha kërkesat që përmbushin kërkesat e nenit 4 dhe paragrafit 5.2.1 të këtij neni. Rregullorja teknike renditet në përmbledhjen e kandidatëve nëse mbështetet nga një votë pozitive në pajtim me paragrafin 7.1 të nenit 7 të aneksit B.

Dokumentacioni i paraqitur me kërkesën për atë rregullore i bashkëngjitet rregullores së renditur teknike.

5.2.3 Rregullorja e kërkuar konsiderohet të renditet nga Sekretari i Përgjithshëm në datën në të cilën mbështetet nga një votë pozitive sipas paragrafit 5.2.2 të këtij neni.

5.3 Heqja e rregulloreve teknike të renditura nga përmbledhja e kandidatëve:

Një rregullore teknike e renditur mund të hiqet nga përmbledhja e kandidatëve.

5.3.1 Me krijimin e regjistrit global të një rregulloreje teknike globale që përmban kërkesat e produktit që adresojnë të njëjtë elemente të rendimentit ose karakteristika të projektimit si të rregullores teknike të renditur;

5.3.2 Në fund të periudhës 5-vjeçare pas renditjes së rregullores sipas këtij neni, dhe në fund të çdo periudhe pasuese 5-vjeçare, përveç kur Komiteti Ekzekutiv riafirmon, me votë pozitive në pajtim me paragrafin 7.1 të nenit 7 të aneksit B, renditjen e rregullores teknike në përmbledhjen e kandidatëve; ose

5.3.3 në përgjigje të një kërkese me shkrim nga pala kontraktuese, me kërkesën e së cilës rregullorja teknike është renditur fillimisht. Një kërkesë e tillë përfshin bazat për heqjen e rregullores.

5.4 Disponimi i dokumenteve

Të gjitha dokumentet e shqyrtuara nga Komiteti Ekzekutiv sipas këtij neni janë publikisht të disponueshme.

Neni 6

Regjistri i rregulloreve teknike globale

6.1 Për rregulloret teknike globale të zhvilluara dhe themeluara sipas këtij neni krijohet dhe mbahet një regjistër. Regjistri njihet si regjistër global.

6.2 Vendosja e rregulloreve teknike globale në regjistrin global nëpërmjet harmonizimit të rregulloreve ekzistuese

Një palë kontraktuese mund të paraqesë një propozim për të zhvilluar një rregullore teknike globale të harmonizuar në lidhje me elementet e rendimentit ose karakteristikave të projektimit të trajtuara nga rregulloret teknike të renditura në përmbledhjen e kandidatëve ose në një rregullore të UN/ECE, ose në të dyja.

6.2.1 Propozimi i specifikuar në paragrafin 6.2 përmban:

6.2.1.1 Një shpjegim të objektivit të rregullores teknike globale të propozuar;

6.2.1.2 Një përshkrim narrativ ose, sipas rastit, projekttekstin e rregullores teknike globale të propozuar;

6.2.1.3 Dokumentacionin e disponueshëm që mund të lehtësojë analizën e çështjeve që duhet të trajtohen në raportin e kërkuar nga paragrafi 6.2.4.2.1 të këtij neni.

6.2.1.4 Një listë të rregulloreve teknike në përmbledhjen e kandidatëve dhe çdo rregullore e UN/ECE, që trajtojnë të njëjtat elemente të rendimentit ose karakteristikave të projektimit që duhet të trajtohen nga rregullorja teknike globale e propozuar; dhe

6.2.1.5 Identifikimin e çdo standardi të njohur përkatës ekzistues ndërkombëtar vullnetar.

6.2.2 Çdo propozim i specifikuar në paragrafin 6.2.1 të këtij neni i paraqitet Komitetit Ekzekutiv.

6.2.3 Komiteti Ekzekutiv nuk i paraqet asnjë pale pune asnjë propozim që ai vendos se nuk i përmbush kërkesat e nenit 4 dhe paragrafit 6.2.1 të këtij neni. Ai mund t'ia paraqesë të gjitha propozimet e tjera një pale të përshtatshme pune.

6.2.4 Në përgjigje të një propozimi të paraqitur atij për zhvillimin e një rregulloreje teknike globale nëpërmjet harmonizimit, pala e punës përdor procedura transparente për të:

6.2.4.1 zhvilluar rekomandime në lidhje me një rregullore teknike globale nëpërmjet:

6.2.4.1.1 shqyrtimit të objektivit të rregullores teknike globale të propozuar dhe nevojës për vendosjen e niveleve alternative të rigorozitetit ose rendimentit;

6.2.4.1.2 rishikimit të të gjitha rregulloreve teknike që janë renditur në përmbledhjen e kandidatëve, dhe çdo rregullore UN/ECE, që trajtojnë të njëjtat elemente të rendimentit;

6.2.4.1.3 rishikimit të çdo dokumentacioni që i bashkëngjitet rregulloreve të specifikuara në paragrafin 6.2.4.1.2 të këtij neni;

6.2.4.1.4 rishikimit të çdo vlerësimi të disponueshëm të ekuivalencës funksionale në lidhje me shqyrtimin e rregullores teknike globale të propozuar, duke përfshirë vlerësimet e standardeve përkatëse;

6.2.4.1.5 verifikimit nëse rregullorja teknike globale që po zhvillohet përmbush objektivat e caktuar të rregullores dhe kriteret e nenit 4; dhe

6.2.4.1.6 shqyrtimit si duhet të mundësisë së rregullores teknike që vendoset sipas marrëveshjes së vitit 1958.

6.2.4.2 I paraqet Komitetit Ekzekutiv:

6.2.4.2.1 Një raport me shkrim që paraqet rekomandimet e tij në lidhje me rregulloren teknike globale, përfshin të gjitha të dhënat dhe informacionin teknik që është shqyrtuar në zhvillimin e rekomandimit të tij, përshkruan shqyrtimin prej tij të informacionit të specifikuar në paragrafin 6.2.4.1 të këtij neni dhe përcakton arsyetimin për rekomandimet, duke përfshirë një shpjegim për refuzimin e çdo kërkese rregullatore alternative dhe qëndrimeve të shqyrtuara; dhe

6.2.4.2.2 Tekstin e çdo rregulloreje teknike globale të rekomanduar.

6.2.5 Komiteti Ekzekutiv, duke përdorur procedura transparente:

6.2.5.1 përcakton nëse rekomandimet në lidhje me rregulloren teknike globale dhe raporti janë bazuar në realizimin e mjaftueshëm dhe të hollësishëm të aktiviteteve të specifikuara në paragrafin 6.2.4.1 të këtij neni. Nëse Komiteti Ekzekutiv përcakton që rekomandimet, raporti dhe/ose teksti i rregullores teknike të rekomanduar, sipas rastit janë të papërshtatshme, ai ia kthen rregulloren dhe raportin palës së punës për rishikim ose punë shtesë.

6.2.5.2 Shqyrton vendosjen e një rregulloreje të rekomanduar teknike globale në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin 7.2 të nenit 7 të aneksit B. Një votë me konsensus nga Komiteti Ekzekutiv në favor të rregullores e vendos rregulloren në regjistrin global.

6.2.6 Rregullorja teknike globale shqyrtohet të vendoset në regjistrin global në datën e votës me konsensus nga Komiteti Ekzekutiv në favor të rregullores.

6.2.7 Sekretariati, me vendosjen e një rregulloreje teknike globale nga Komiteti Ekzekutiv, i bashkëngjit asaj rregulloreje kopje të të gjithë dokumentacionit përkatës, duke përfshirë propozimin e paraqitur në pajtim me paragrafin 6.2.1 të këtij neni dhe rekomandimet, dhe raportin e kërkuar nga paragrafi 6.2.4.2.1 të këtij neni të asaj rregulloreje.

6.3 Vendosja e rregulloreve të reja teknike globale në regjistrin global

Një palë kontraktuese mund të paraqesë një propozim për të zhvilluar një rregullore të re teknike globale në lidhje me elementet e rendimentit ose karakteristikat e projektimit që nuk trajtohen nga rregulloret teknike në përmbledhjen e kandidatëve ose rregulloret e UN/ECE.

6.3.1 Propozimi i specifikuar në paragrafin 6.3 përmban:

6.3.1.1 Një shpjegim të objektivit të rregullores teknike globale të re të propozuar, bazuar në të dhëna objektive në masën e mundur;

6.3.1.2 Një përshkrim narrativ, sipas rastit, të projekttekstit të rregulores teknike globale të re të propozuar;

6.3.1.3 Çdo dokumentacion të disponueshëm që mund të lehtësojë analizën e çështjeve që duhet të trajtohen në raportin e kërkuar nga paragrafi 6.3.4.2.1 të këtij neni; dhe

6.3.1.4 Identifikimin e çdo standardi të njohur përkatës ekzistues ndërkombëtar vullnetar.

6.3.2 Çdo propozim i specifikuar në paragrafin 6.3.1 të këtij neni i paraqitet Komitetit Ekzekutiv.

6.3.3 Komiteti Ekzekutiv nuk i paraqet asnjë pale ndonjë propozim që ai vendos se nuk përmbush kërkesat e nenit 4 dhe paragrafit 6.3.1 të këtij neni. Ai mund t'ia paraqesë të gjitha propozimet e tjera një pale të përshtatshme pune.

6.3.4 Në përgjigje të një propozimi që i është paraqitur për zhvillimin e një rregulloreje teknike globale të re, pala e punës përdor metoda transparente:

6.3.4.1 për të zhvilluar rekomandime në lidhje me një rregullore teknike globale të re nëpërmjet:

6.3.4.1.1 shqyrtimit të objektivit të rregullores teknike globale të re të propozuar dhe të nevojës për vendosjen e niveleve alternative të rigorozitetit të rendimentit;

6.3.4.1.2 shqyrtimit të bëshmërisë teknike;

6.3.4.1.3 shqyrtimit të bëshmërisë ekonomike;

6.3.4.1.4 shqyrtimit të përfitimeve, duke përfshirë ato të kërkesave rregullatore alternative dhe përqasjeve të shqyrtuara;

6.3.4.1.5 krahasimit të efektivitetit të mundshëm të kostos së rregullores së rekomanduar me atë të kërkesave rregullatore alternative dhe përqasjeve të shqyrtuara;

6.3.4.1.6 verifikimit nëse rregullorja e re teknike globale në zhvillim përmbush objektivin e caktuar të rregullores dhe kriteret në nenin 4; dhe

6.3.4.1.7 shqyrtimit të përshtatshëm të mundësisë së rregullores teknike që vendoset në pajtim me marrëveshjen e vitit 1958.

6.3.4.2 I paraqet Komitetit Ekzekutiv:

6.3.4.2.1 Një raport me shkrim që paraqet rekomandimin e tij në lidhje me rregulloren teknike globale, përfshin të gjitha të dhënat dhe informacionin teknik që është shqyrtuar në zhvillimin e rekomandimit të tij, përshkruan shqyrtimin prej tij të informacionit të përcaktuar në paragrafin 6.3.4.1 të këtij neni dhe përcakton arsyetimin për rekomandimin e tij, duke përfshirë një shpjegim për refuzimin e çdo kërkese rregullatore alternative dhe përqasjeve të shqyrtuara; dhe

6.3.4.2.2 tekstin e çdo rregulloreje të re teknike globale të rekomanduar.

6.3.5 Komiteti Ekzekutiv, duke përdorur procedura transparente:

6.3.5.1 përcakton nëse rekomandimi në lidhje me rregulloren e re teknike globale dhe raporti janë bazuar në realizimin e mjaftueshëm dhe të plotë të aktiviteteve të specifikuara në paragrafin 6.3.4.1 të këtij neni. Nëse Komiteti Ekzekutiv arrin përfundimin që rekomandimet, raporti dhe/ose teksti i rregullores së re teknike globale të rekomanduar, sipas rastit, janë të papërshtatshme, ai ia kthen rregulloren dhe raportin palës së punës për rishikim ose punë shtesë.

6.3.5.2 Shqyrton vendosjen e një rregulloreje të re teknike globale të rekomanduar në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin 7.2 të nenit 7 të aneksit B. Një votë me konsensus nga Komiteti Ekzekutiv në favor të rregullores e vendos rregulloren në regjistrin global.

6.3.6 Rregullorja teknike globale shqyrtohet të vendoset në regjistrin global në datën e votës me konsensus nga Komiteti Ekzekutiv në favor të rregullores.

6.3.7 Sekretariati, me vendosjen e një rregulloreje të re teknike globale nga Komiteti Ekzekutiv, i bashkëngjit asaj rregulloreje kopje të të gjithë dokumentacionit përkatës, duke përfshirë propozimin e paraqitur në pajtim me paragrafin 6.3.1 të këtij neni dhe rekomandimet dhe raportin e kërkuar nga paragrafi 6.3.4.2.1 të këtij neni të asaj rregulloreje.

6.4 Ndryshimi i rregulloreve teknike globale të vendosura

Procesi për ndryshimin e çdo rregulloreje teknike globale të vendosur në regjistrin global, sipas këtij neni janë procedurat e përcaktuara në paragrafin 6.3 të këtij neni për vendosjen e një rregulloreje të re teknike globale në regjistrin global.

6.5 Disponueshmëria e dokumenteve

Të gjitha dokumentet e shqyrtuara ose gjeneruara nga pala e punës në rekomandimin e rregulloreve teknike globale sipas këtij neni janë të disponueshme publikisht.

Neni 7

Miratimi i rregulloreve teknike globale të vendosura dhe njoftimi i kërkesave

7.1 Një palë kontraktuese që voton në favor të vendosjes së rregullores teknike globale sipas nenit 6 të kësaj marrëveshjeje është e detyruar ta paraqesë rregulloren teknike për procesin që zbatohet nga ajo palë kontraktuese për ta përfshirë këtë rregullore teknike në ligjet ose rregulloret e veta dhe kërkon të merret një vendim përfundimtar në mënyrë të përshpejtuar.

7.2 Një palë kontraktuese që përfshin një rregullore teknike globale të vendosur në ligjet ose rregulloret e saj njofton Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim për datën në të cilën ajo rregullore do të fillojë të zbatohet. Njoftimi jepet brenda 60 ditëve pas vendimit për miratimin e asaj rregulloreje. Nëse rregullorja teknike globale e vendosur përmban më shumë se një nivel rigoroziteti ose rendimenti, njoftimi përcakton cili prej këtyre niveleve të rigorozitetit ose rendimentit është zgjedhur nga pala kontraktuese.

7.3 Një palë kontraktuese që është specifikuar në paragrafin 7.1 të këtij neni dhe që vendos për të mos e përfshirë rregulloren teknike globale të vendosur në ligjet ose rregulloret e tij, e njofton Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim për këtë vendim, si dhe për kriteret bazë të vendimit. Njoftimi bëhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas vendimit.

7.4 Një palë kontraktuese që është specifikuar në paragrafin 7.1 të këtij neni që deri në fund të një periudhe njëvjeçare nga vendosja e rregullores në regjistrin global nuk e ka përfshirë atë rregullore teknike ose nuk ka vendosur ta përfshijë atë rregullore në ligjet dhe rregulloret e veta, paraqet një raport mbi statusin e rregullores në procesin e brendshëm. Raporti i statusit paraqitet për çdo periudhë njëvjeçare pasuese nëse nuk është ndërmarrë asnjë nga ato veprime deri në fund të periudhës. Çdo raport i kërkuar nga ky paragraf:

7.4.1 Përfshin një përshkrim të hapave të ndërmarrë gjatë vitit të kaluar për paraqitjen e rregullores dhe marrjen e një vendimi përfundimtar dhe një tregues për datën e parashikuar për një vendim të tillë; dhe

7.4.2 I paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se 60 ditë pas fundit të periudhës njëvjeçare për të cilën paraqitet raporti.

7.5 Një palë kontraktuese që pranon produkte që përputhen me një rregullore teknike globale të vendosur pa e përfshirë këtë rregullore në ligjet ose rregulloret e veta, njofton Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim për datën në të cilën ka filluar të pranojë këto produkte. Pala kontraktuese e paraqet njoftimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas fillimit të një pranimi të tillë. Nëse rregullorja teknike globale e vendosur përmban më shumë se një nivel rigoroziteti ose rendimenti, njoftimi përcakton se cilat nga këto nivele rigoroziteti ose rendimenti është përzgjedhur nga pala kontraktuese.

7.6 Një palë kontraktuese që ka përfshirë në ligjet ose rregulloret e saj një rregullore teknike globale të vendosur, mund të vendosë të anulojë ose ndryshojë rregulloren e miratuar. Para marrjes së këtij vendimi, pala kontraktuese njofton Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim për synimin dhe arsyet e saj për të shqyrtuar këtë veprim. Kjo dispozitë për njoftimin zbatohet, gjithashtu, edhe për një palë kontraktuese që ka pranuar produkte sipas paragrafit 7.5 dhe që synon të pushojë së pranuari këto produkte. Pala kontraktuese njofton Sekretarin e Përgjithshëm për vendimin e saj për të miratuar çdo rregullore të ndryshuar ose të re brenda 60 ditëve pas këtij vendimi. Me kërkesë, pala kontraktuese u paraqet palëve të tjera kontraktuese menjëherë kopje të kësaj rregulloreje të ndryshuar ose të re.

Neni 8

Zgjidhja e çështjeve

8.1 Çështjet në lidhje me dispozitat e një rregulloreje teknike globale të vendosur i paraqiten për zgjidhje Komitetit Ekzekutiv.

8.2 Çështjet ndërmjet dy ose më shumë palëve kontrakteuse në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për aq sa është e mundur, zgjidhen nëpërmjet konsultimeve ose

bisedimeve ndërmjet tyre. Nëse ky proces nuk e zgjidh çështjen, palët kontraktuese të interesuara mund të bien dakord t'i kërkojnë Komitetit Ekzekutiv të zgjidhin çështjen sipas parashikimit në paragrafin 7.3 të nenit 7 të aneksit B.

Neni 9
Bërja palë kontraktuese

9.1 Vendet dhe organizatat rajonale të integrimit ekonomik të specifikuara në nenin 2 mund të bëhen palë kontraktuese në këtë marrëveshje nëpërmjet:

9.1.1 Nënshkrimit pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose aprovimin;

9.1.2 Nënshkrimit duke iu nënshtruar ratifikimit, pranimit ose aprovimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi;

9.1.3 Pranimit; ose

9.1.4 Aderimit.

9.2 Instrumenti i ratifikimit, pranimit ose aderimit depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm.

9.3 Në momentin e bërjes palë kontraktuese

9.3.1 Pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, secili vend ose organizatë rajonale e integrimit bën njoftim në pajtim me nenin 7, nëse ka, se cilën rregullore(t) teknike globale të vendosur në pajtim me nenin 6 do të miratojë dhe për çdo vendim për të pranuar produkte që përputhen me ndonjë prej atyre rregulloreve teknike, pa i përfshirë ato rregullore në ligjet ose rregulloret e veta. Nëse rregullorja teknike globale e vendosur përmban më shumë se një nivel të rigorozitetit ose rendimentit, njoftimi specifikon, cilat nga nivelet e rigorozitetit ose rendimentit miratohet ose pranohet nga pala kontraktuese.

9.3.2 Çdo organizatë rajonale e integrimit teknik deklaron për çështjet brenda kompetencës së saj që shtetet anëtare të saj kanë transferuar kompetencat në fushat e mbuluara nga marrëveshja, duke përfshirë kompetencën për të nxjerrë vendime detyruese për shtetet e saj anëtare.

9.4 Organizatat rajonale të integrimit ekonomik që janë palë kontraktuese pushojnë së qeni palë kontraktuese nëse ato humbin kompetencat e deklaruara në pajtim me paragrafin 9.3.2 të këtij neni dhe informon për këtë Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 10
Nënshkrimi

10.1 Kjo marrëveshje është e hapur për nënshkrim, duke filluar nga data 25 qershor 1998.

10.2 Kjo marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim deri në hyrjen e saj në fuqi.

Neni 11
Hyrja në fuqi

11.1 Kjo marrëveshje dhe anekset e saj, që përbëjnë pjesë integrale të marrëveshjes, hyjnë në fuqi në ditën e tridhjetë (30) pas datës në të cilën një minimum prej pesë (5) vendesh dhe/ose organizatash rajonale të integrimit ekonomik janë bërë palë kontraktuese në pajtim me nenin 9. Ky minimum prej pesë (5) anëtarësh duhet të përfshijë Komunitetin Europian, Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

11.2 Megjithatë, nëse paragrafi 11.1 i këtij neni nuk përmbushet brenda pesëmbëdhjetë (15) muajve pas datës së përcaktuar në paragrafin 10.1, kjo marrëveshje dhe anekset e saj që përbëjnë pjesë përbërëse të marrëveshjes, hyjnë në fuqi në ditën e tridhjetë (30), pas datës në të cilën një minimum prej tetë (8) vendesh dhe/ose organizatash rajonale të integrimit ekonomik janë bërë palë kontraktuese në pajtim me nenin 9. Kjo datë e hyrjes në fuqi nuk është më parë se gjashtëmbëdhjetë (16) muaj pas datës së përcaktuar në paragrafin 10.1. Të paktën një (1) prej këtyre tetë (8) anëtarëve duhet të jetë Komuniteti Europian, Japonia ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

11.3 Për çdo vend ose organizatë rajonale të integrimit ekonomik që bëhet palë kontraktuese në marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, kjo marrëveshje hyn në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës që ky vend ose organizatë rajonale e integrimit ekonomik depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

Neni 12
Tërheqja nga Marrëveshja

12.1 Një palë kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo marrëveshje nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjitshëm me shkrim.

12.2 Tërheqja nga kjo marrëveshje nga një palë kontraktuese hyn në fuqi një vit pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm merr njoftimin në pajtim me paragrafin 12.1 të këtij neni.

Neni 13
Ndryshimi i marrëveshjes

13.1 Një palë kontraktuese mund të propozojë ndryshime për këtë Marrëveshje dhe anekset në këtë Marrëveshje. Ndryshimet e propozuara i paraqiten Sekretarit të Përgjithshëm i cili ua transmeton ato të gjithë palëve kontraktuese.

13.2 Një ndryshim i propozuar i transmetuar në pajtim me paragrafin 13.1 të këtij neni shqyrtohet nga Komiteti Ekzekutiv në mbledhjen pasuese të radhës.

13.3 Nëse ka votë me konsensus në favor të ndryshimit nga palët kontraktuese të pranishme dhe që votojnë, ai i komunikohet nga Komiteti Ekzekutiv, Sekretarit të Përgjithshëm që më tej ua transmeton ndryshimin të gjitha palëve kontraktuese.

13.4 Një ndryshim i qarkulluar sipas paragrafit 13.3 të këtij neni konsiderohet të jetë pranuar nga të gjitha palët kontraktuese, nëse asnjë palë kontraktuese nuk shpreh asnjë kundërshtim brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh pas datës së këtij qarkullimi. Nëse nuk është shprehur ndonjë kundërshtim i tillë, ndryshimi hyn në fuqi për të gjitha palët kontraktuese tre (3) muaj pas skadimit të periudhës prej gjashtë (6) muajsh të përmendur në këtë paragraf.

13.5 Sekretari i Përgjithshëm, sa më shpejt të jetë e mundur, njofton të gjitha palët kontraktuese nëse është shprehur ndonjë kundërshtim për ndryshimin e propozuar. Nëse një kundërshtim i tillë është shprehur, ndryshimi konsiderohet të mos jetë pranuar dhe është pa asnjë lloj efekti.

Neni 14
Depozituesi

Depozituesi i kësaj Marrëveshjeje është Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Përveç funksioneve të tjera të depozituesit, Sekretari i Përgjithshëm, sa më shpejt të jetë e mundur, njofton palët kontraktuese për:

14.1 Renditjen ose heqjen e rregulloreve teknike sipas nenit 5;

14.2 Vendosjen ose ndryshimin e rregulloreve teknike globale sipas nenit 6;

14.3 Njoftimet e marra në pajtim me nenin 7;

14.4 Nënshkrimet, pranimet dhe aderimet në pajtim me nenet 9 dhe 10;

14.5 Njoftimet e marra në pajtim me nenin 9;

14.6 Datat në të cilat kjo Marrëveshje hyn në fuqi për palët kontraktuese në pajtim me nenin 11;

14.7 Njoftimet e tërheqjes nga kjo Marrëveshje të marra në pajtim me nenin 12;

14.8 Datën e hyrjes në fuqi të çdo ndryshimi të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 13;

14.9 Njoftimet e marra në pajtim me nenin 15 në lidhje me territoret.

Neni 15
Zgjerimi i Marrëveshjes në territore

15.1 Kjo Marrëveshje zgjerohet në çdo territor ose territore të një pale kontraktuese për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilës është përgjegjëse kjo palë kontraktuese, përveç kur pala kontraktuese specifikon ndryshe, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për atë palë kontraktuese.

15.2 Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Marrëveshje veçmas për çdo territor ose territore të tilla në pajtim me nenin 12.

Neni 16
Sekretariati

Sekretariati i kësaj marrëveshjeje është Sekretari Ekzekutiv i UN/ECE. Sekretari Ekzekutiv përmbush funksionet e mëposhtme të sekretarisë.

16.1 Përgatit mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të palëve të punës;

16.2 U transmeton palëve kontraktuese raporte dhe informacione të tjera të marra në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje; dhe

16.3 Përmbush funksionet e ngarkuara nga Komiteti Ekzekutiv.

ANEKSI A
PËRKUFIZIME

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. Për sa u përket rregulloreve teknike globale të hartuara sipas kësaj marrëveshjeje, shprehja “pranon” kupton veprimin e një pale kontraktuese për lejimin e hyrjes në tregun e saj të produkteve që janë në përputhje me rregulloren teknike globale pa e adaptuar këtë rregullore teknike globale në ligjet dhe rregulloret e saj përkatëse.

2. Për sa u përket rregulloreve teknike globale të hartuara sipas kësaj marrëveshjeje, shprehja "përshtat" kupton dekretimin e një rregulloreje teknike globale në ligje dhe rregullore të një pale kontraktuese.

3. Për sa u përket rregulloreve teknike globale të hartuara sipas kësaj marrëveshjeje, shprehja “zbaton” kupton veprimin e përputhjes së nevojshme me një rregullore teknike globale nga një palë kontraktuese brenda një date të caktuar, me fjalë të tjera, datën e hyrjes në fuqi të rregullores në juridiksionin e palës kontraktuese.

4. Shprehja “nen” kupton një nen të kësaj Marrëveshjeje.

5. Shprehja “votë konsensusi” kupton një votë për çështjen në të cilën asnjë palë kontraktuese paraqet dhe kundërshton votimin e çështjes sipas paragrafit 7.2 të nenit 7 të aneksit B.

6. Shprehja “palë kontraktuese” kupton çdo vend, ose organizëm integrimi rajonal ekonomik, që është palë kontraktuese e kësaj marrëveshjeje.

7. Shprehja “pajisje dhe pjesë këmbimi, të cilat instalohen dhe/ose përdoren në mjete me rrota” kupton pajisje dhe/ose pjesë këmbimi karakteristikat e të cilave kanë ndikim në sigurinë, mbrojtjen mjedisore, efikasitetin e energjisë ose cilësinë kundër vjedhjes. Këto pajisje dhe pjesë këmbimi përfshijnë, por nuk janë vetëm të kufizuara në sistemet e shkarkimit të gazrave, gomat, motorët, mbrojtje akustike, alarmet kundër vjedhjes, pajisjet lajmëruese, dhe sistemet e fiksimit për fëmijë.

8. Shprehja “rregullore teknike globale e vendosur” kupton një rregullore teknike globale që është vendosur në regjistrin global në përputhje me këtë Marrëveshje.

9. Shprehja “rregullore teknike e listuar” kupton një rregullore teknike kombëtare ose rajonale, e cila është vendosur në përmbledhjen e kandidatëve në përputhje me këtë Marrëveshje.

10. Shprehja “vetëcertifikim i prodhuesit” kupton një kërkesë ligjore të një pale kontraktuese që një prodhues i mjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit, të cilat mund të instalohen dhe/ose

përdoren në mjetet me rrota duhet të vërtetojë që çdo mjet, njësi pajisjeje ose pjesë këmbimi që prodhuesi paraqet në treg plotëson kërkesat teknike specifike.

11. Shprehja "organizata integrimi rajonal ekonomik" kupton një organizatë e cila është krijuar dhe përbërë nga vende sovrane dhe e cila ka kompetencën për çështjet e mbuluara nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë autoritetin për të nxjerrë vendime detyruese për të gjitha vendet anëtare në lidhje me këto çështje.

12. Shprehja "Sekretar i Përgjithshëm" kupton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

13. Shprehja "procedura transparente" kupton procedurat e hartuara për të promovuar sensibilizimin e publikut për dhe pjesëmarrjen në proceset e zhvillimit të rregulloreve sipas kësaj Marrëveshjeje. Ato duhet të përfshijnë publikimin e:

1) njoftimit të takimeve të grupeve të punës dhe të Komitetit Ekzekutiv; dhe

2) dokumentacionit të punës dhe atij final.

Ato duhet gjithashtu të përfshijnë mundësinë për të paraqitur pikëpamje dhe argumente në:

1) takimet e grupeve të punës të organizmave që u është dhënë statusi konsultativ; dhe

2) takimet e grupeve të punës dhe të Komitetit Ekzekutiv të përfaqësuesve të palëve kontraktuese përmes konsultimeve paraprake.

14. Shprehja "miratim tipi" kupton miratimin me shkrim të një pale kontraktuese (ose të autoritetit kompetent të caktuar nga pala kontraktuese) që një mjet dhe/ose njësi pajisjeje dhe/ose pjesë këmbimi që mund të instalohet dhe/ose përdoret në një mjet, plotëson kërkesat teknike specifike, dhe përdoret si një parakusht për futjen e mjetit, të pajisjes dhe pjesës së këmbimit në treg.

15. Shprehja "Rregullore UN/ECE" kupton Komisionin Ekonomik/Kombet e Bashkuara për rregulloret e Europës miratuar sipas marrëveshjes 1958.

16. Shprehja "grup pune" kupton një organ të specializuar teknik në varësi të ECE-s, funksion i të cilit është të zhvillojë rekomandime lidhur me hartimin e rregulloreve të reja teknike globale për t'u përfshirë në regjistrin global dhe të konsiderojë përmirësime të rregulloreve teknike globale të vendosura në regjistrin global.

17. Shprehja "Marrëveshja 1958" kupton marrëveshjen lidhur me miratimin e parashikimeve teknike uniforme për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen reciproke të aprovimeve të dhëna mbi bazën e këtyre parashikimeve.

ANEKSI B
PËRBËRJA DHE RREGULLAT E PROCEDURËS SË KOMITETIT EKZEKUTIV

Neni 1

Anëtarësimi në Komitetin Ekzekutiv duhet të kufizohet deri te palët kontraktuese.

Neni 2

Të gjitha palët kontraktuese duhet të jenë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv.

Neni 3

3.1 Me përjashtim për sa thuhet në paragrafin 3.2 të këtij neni, çdo palë kontraktuese duhet të ketë një votë.

3.2 Nëse një organizatë integrimi rajonal ekonomik dhe një ose më shumë të shteteve anëtare janë palë kontraktuese të kësaj marrëveshjeje, organizata e integrimit ekonomik rajonal do të ushtrojë,

për çështjet e kompetencës së saj, të drejtën e saj për të votuar me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të saj që janë palë kontraktuese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Për të hedhur votën e saj, një palë kontraktuese duhet të jetë e pranishme. Një palë kontraktuese nevojitet të jetë e pranishme për hedhjen e votës nga organizata e saj e integrimit rajonal ekonomik.

Neni 5

5.1 Një kuorum që përbëhet nga jo më pak se gjysma e të gjitha palëve kontraktuese duhet të jetë i pranishëm gjatë votimit.

5.2 Me qëllim të përcaktimit të një kuorumi sipas këtij neni, dhe përcaktimit të numrit të palëve kontraktuese të nevojshme për të përbërë një të tretën e palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë sipas paragrafit 7.1 të nenit 7 të këtij aneksi, një organizatë integrimi rajonal ekonomik dhe shtetet anëtare të saj duhet të numërohen si një palë kontraktuese.

Neni 6

6.1 Komiteti Ekzekutiv do të zgjedhë në sesionin e tij të parë të çdo viti kalendarik, një kryetar dhe zëvendëskryetar nga anëtarësia. Kryetari dhe zëvendëskryetari duhet të zgjidhen nga dy të tretat e votës pohuese të të gjitha palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë.

6.2 Kryetari dhe zëvendëskryetari, nuk duhet të vijnë nga e njëjta palë kontraktuese më shumë se dy vjet në vazhdimësi. Në çdo vit, kryetari dhe zëvendëskryetari nuk duhet të vijnë nga e njëjta palë kontraktuese.

Neni 7

7.1 Një rregullore kombëtare ose rajonale duhet të listohet në përmbledhjen e kandidatëve nga një votë pohuese e ose së paku një e treta e palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë (siç përcaktohet në nenin 5.2 të këtij aneksi) ose një e treta e numrit total të votave të hedhura, cilado është më e favorshme për arritjen e një vote pohuese. Në çdo rast, një e treta duhet të përfshijë votën e ose Bashkimit Europian, Japonisë ose Shteteve të Bashkuara, nëse çdonjëra prej tyre është palë kontraktuese.

7.2 Vendosja e një rregulloreje teknike globale në regjistrin global, që ndryshon një rregullore teknike globale të vendosur dhe ndryshon këtë Marrëveshje duhet të bëhet përmes një vote konsensusi të palëve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë. Një palë kontraktuese e pranishme që voton dhe kundërshton për një çështje për të cilën një votë konsensusi është e nevojshme për miratim duhet të japë shpjegim me shkrim për kundërshtimin e saj te Sekretari i Përgjithshëm brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e votimit. Nëse pala kontraktuese e tillë nuk arrin të japë këtë shpjegim gjatë kësaj periudhe, do të konsiderohet sikur ka votuar në favor të çështjes për të cilën është votuar. Nëse të gjitha palët kontraktuse që kanë kundërshtuar çështjen veprojnë kështu, vota mbi çështjen do të konsiderohet një votë konsensusi në favor të çështjes nga të gjithë personat e pranishëm dhe që votojnë. Në këtë rast, data e votimit do të konsiderohet të jetë dita e parë pas periudhës 60-ditore.

7.3 Të gjitha çështjet e tjera që kërkojnë zgjidhje mundet, sipas gjykimit të Komitetit Ekzekutiv, të zgjidhen përmes procesit të votimit të parashikuar në paragrafin 7.2 të këtij neni.

Neni 8

Palët kontraktuese që abstenojnë në votim konsiderohen sikur nuk votojnë.

Neni 9

Sekretaria ekzekutive duhet të thërrasë Komitetin Ekzekutiv kurdoherë që kërkohet një votim sipas neneve 5, 6 dhe 13 të kësaj Marrëveshjeje ose kurdoherë të jetë e nevojshme për të kryer aktivitete sipas kësaj Marrëveshjeje.

LIGJ
Nr. 71/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, fjalia e parë e nenit 30 ndryshohet si më poshtë:

"1. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, kështet tremujore të tatimin mbi fitimin, brenda datës 30 mars për muajt janar, shkurt dhe mars, brenda datës 30 qershor për muajt prill, maj dhe qershor, brenda datës 30 shtator për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 30 dhjetor për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumat si më poshtë:".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013.

Miratuar në datën 28.6.2012

Shpallur me dekretin nr.7720, datë 20.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 72/2012

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për:

a) krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë;

b) organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor;

c) përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, përditësimin, ndërveprimin, aksesin, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor;

ç) detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për krijimin, sigurinë, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e tyre që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) lidhen me një ose më shumë nga temat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij;

b) lidhen me zona brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) janë në format elektronik;

ç) mbahen nga dhe për llogari të:

i) një autoriteti publik, kur janë prodhuar ose janë marrë nga një autoritet publik apo administrohen ose përditësohen nga ky autoritet dhe përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij;

ii) një pale të tretë, së cilës i janë vënë në dispozicion shërbimet e rrjetit të të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me këtë ligj.

---

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me:*

Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 "Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Europian (INSPIRE)". Numri CELEX: 32007L0002, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 108, datë 25.4.2007, faqe 1 – 14.

2. Në rastet kur ekzistojnë kopje identike të shumëfishta që u përkasin të njëjtave të dhëna gjeohapësinore, të cilat mbahen nga ose për llogari të autoriteteve publike, ky ligj zbatohet vetëm për versionin origjinal të të dhënave gjeohapësinore, prej të cilit janë krijuar kopjet e tjera.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "ASIG" është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

2. "Autoritet publik" është:

a) çdo organ i pushtetit qendror dhe vendor, që kryen funksione administrative, si dhe entet publike që kryejnë funksione administrative;

b) çdo person fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose kryen funksione publike apo që ofron shërbime publike nën kontrollin e autoriteteve të parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike.

3. "BIG" është Bordi i Informacionit Gjeohapësinor.

4. "Baza e të dhënave shtetërore" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar nga ligji nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore".

5. "Rikuperimi nga katastrofa" është procesi që lidhet me përgatitjen për rikuperim dhe vazhdimësinë e funksionimit të infrastrukturës teknologjike të informacionit me rëndësi të posaçme për autoritetin administrues, pas një katastrofe natyrore ose të shkaktuar nga njeriu.

6. "GIS" është Sistemi i Informacionit Gjeografik që mbledh, ruan, analizon, përpunon dhe paraqet të dhëna që lidhen me një fenomen natyror apo shoqëror, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.

7. "GIS Kombëtar" është Sistemi Kombëtar i Informacionit Gjeohapësinor, i cili përfshin të gjitha sistemet e informacionit gjeografik që ndërtohen për tema të veçanta, në përputhje me standardet e miratuara nga ASIG-u, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe që integrohen nga ASIG-u.

8. "Grup të dhënash gjeohapësinore" është një koleksion i identifikueshëm të dhënash gjeohapësinore.

9. "Gjeoreferencim" është përcaktimi i pozicionit gjeohapësinor të një objekti apo fenomeni duke u mbështetur në një sistem hapësinor koordinativ.

10. "Gjeoportal" është një sistem, i cili nëpërmjet internetit përdor një ndërfaqe grafike qendrore dhe unike, nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të zbulojnë, të shikojnë dhe të përdorin informacionin gjeohapësinor dhe shërbimet e rrjetit që lidhen me këtë informacion, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

11. "Informacion gjeohapësinor" janë metadatat, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen çfarëdo të realitetit, gjeoreferencimi i të cilit mundësohet nga një sistem hapësinor koordinativ i përbashkët.

12. "Infrastruktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor" është infrastruktura që përfshin autoritetet kombëtare përgjegjëse për të dhënat gjeohapësinore, metadatat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, shërbimet e rrjetit dhe teknologjitë, marrëveshjet për shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin, si dhe mekanizmat e koordinimit e të monitorimit, proceset dhe procedurat, të krijuara, të vëna në veprim ose të vëna në dispozicion në përputhje me këtë ligj.

13. "Korniza Referuese Gjeodezike" është baza mbi të cilën mbështetet përcaktimi unik tredimensional i pozicionit të një pike në tokë dhe përbëhet nga:

a) parametrat themelorë gjeodezikë;

b) sistemi i koordinatave gjeodezike;

c) sistemi i lartësive;

ç) sistemi i koordinatave në plan, i cili mbështetet te koordinatat gjeodezike dhe në projeksionin hartografik;

d) rrjeti gravimetrik dhe rrjetet e tjera gjeodezike;

dh) sistemi i emërtesave.

14. "Metadata" është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave e të grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

15. "Ndërveprueshmëria" është aftësia e sistemeve të ndryshme për të punuar bashkë, pa ndërhyrje manuale të përsëritura, në mënyrë që rezultati i bashkëveprimit të jetë i qartë dhe të çojë në rritjen e vlerës së shtuar të grupeve dhe shërbimeve të të dhënave.

16. "Palë e tretë" është çdo person fizik ose juridik, i ndryshëm nga autoriteti publik i përkufizuar në pikën 2 të këtij neni.

17. "Shërbime për informacionin gjeohapësinor" janë operacionet që mund të realizohen, përmes aplikacioneve kompjuterike, për informacionin gjeohapësinor, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore ose për metadatat që lidhen me to.

18. "Të dhëna gjeohapësinore" është çdo e dhënë që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë një vendi ose zone gjeografike të veçantë.

19. "Objekt gjeohapësinor" është përfaqësimi abstrakt i një fenomeni të botës reale lidhur me një vend ose zonë gjeografike të veçantë.

20. "Ministri" është ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

Neni 4
Parimet

Krijimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e:

a) ligjshmërisë;

b) mbrojtjes së interesit publik;

c) informimit të publikut me informacionin zyrtar;

ç) mbrojtjes së të dhënave personale;

d) mbrojtjes së pronësisë intelektuale;

dh) transparencës;

e) zhvillimit të qëndrueshëm;

ë) ofrimit të shërbimeve me cilësi përkundrejt kostove efektive.

KREU II
AUTORITETET KOMBËTARE TË INFRASTRUKTURËS
SË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Neni 5
Struktura kombëtare e informacionit gjeohapësinor

1. Autoritetet kombëtare përgjegjëse për informacionin gjeohapësinor janë Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (BIG) dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, sipas legjislacionit në fuqi.

2. ASIG-u është institucion vendimmarrës, ekzekutiv dhe koordinues që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

3. BIG-u është organ këshillimor që ushtron veprimtarinë e tij me kohë të pjesshme dhe mblidhet sa herë që është e nevojshme për realizimin e veprimtarisë së përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji.

4. Autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor janë autoritetet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, ngarkohen me këto përgjegjësi.

Neni 6
Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor

1. ASIG-u është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit.

2. ASIG-u e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhura të tjera, të ligjshme.

3. Rregulla të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ASIG-ut miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 7
Përgjegjësitë e ASIG-ut

ASIG-u ka këto përgjegjësi:

a) zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;

b) është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike;

c) merr vendime për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;

ç) përcakton standardet shtetërore dhe rregullat uniforme për krijimin e GIS-it, për secilën temë, dhe për krijimin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet europiane përkatëse dhe harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të;

d) siguron ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të informacionit gjeohapësinor, si dhe harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë;

dh) administron informacionin gjeohapësinor të mbledhur, të përpunuar dhe të përditësuar nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse;

e) siguron bashkërendimin e punës gjatë aktiviteteve dhe marrjes së nismave që lidhen me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat;

ë) krijon dhe administron Gjeoportalin Kombëtar dhe garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

f) mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të vendosur nga ky ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji dhe, në përputhje me politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, u paraqet autoriteteve përkatëse propozime për ndërhyrje legjislative që lidhen me to;

g) kujdeset për edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në proceset që lidhen me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, si dhe për përhapjen e informacionit që lidhet me të te grupet e interesit dhe te publiku;

gj) përfaqëson shtetin në organizatat europiane dhe ndërkombëtare, anëtarësimi në të cilat i shërben funksionimit dhe modernizimit të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor;

h) përfaqëson shtetin për çdo çështje tjetër që lidhet me infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor.

Neni 8
Drejtori i ASIG-ut

1. Drejtori i ASIG-ut drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.

2. Drejtori i ASIG-ut emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për emërimin, shkarkimin apo lirimin nga detyra të titullarëve të institucioneve qendrore në varësi të ministrave të linjës.

3. Drejtor i ASIG-ut mund të zgjidhet personi që:

a) ka shtetësi shqiptare;

b) ka zotësi të plotë për të vepruar;

c) ka mbaruar një program të studimit të ciklit të dytë, ose ekuivalent, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, inxhinier gjeodet, gjeoinformatikë ose teknologji informacioni;

ç) gëzon figurë të pastër morale dhe profesionale;

d) ka jo më pak se 5 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

Neni 9
Nëpunësit e ASIG-ut

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASIG-ut rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

2. Struktura dhe organika e ASIG-ut miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për hartimin dhe miratimin e strukturave organizative të institucioneve të administratës publike.

Neni 10
Bordi i Informacionit Gjeohapësinor

1. BIG-u është organ këshillimor i ASIG-ut dhe i Këshillit të Ministrave për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. Përbërja, fusha e veprimtarisë, të ftuarit në mbledhjet e BIG-ut, si dhe rregullat më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij bordi përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

KREU III
TË DHËNAT GJEOHAPËSINORE, METADATAT
DHE GIS-I KOMBËTAR

Neni 11
Temat e të dhënave gjeohapësinore

1. Të dhënat gjeohapësinore krijohen, mblidhen, përditësohen dhe vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, sipas klasifikimit dhe përkatësisë së tyre në temat e veçanta.

2. Temat e të dhënave gjeohapësinore përfshijnë:

a) përcaktimin e kornizës referuese gjeodezike dhe kontrollin gjeodezik;

b) sistemet e rrjeteve gjeografike;

c) emërtimet gjeografike;

ç) imazhin e hartës bazë;

d) kufijtë e njësive administrative;

dh) sistemin e adresave;

e) parcelat kadastrale;

ë) rrjetet e transportit;

f) hidrografinë;

g) zonat e mbrojtura;
gj) modelin dixhital të terrenit;
h) mbulesën e tokës;
i) ortoimazherinë;
j) gjeologjinë;
k) njësitë statistikore;
l) ndërtesat;
ll) pedologjinë;
m) përdorimin e tokës;
n) shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e tij;
nj) infrastrukturën urbane dhe shërbimet qeveritare;
o) infrastrukturën për monitorimin e mjedisit;
p) infrastrukturën industriale;
q) infrastrukturën bujqësore dhe akuakulturën;
r) demografinë;
rr) zonat me përdorim të kufizuar;
s) zonat me rreziqe natyrore;
sh) kushtet atmosferike;
t) meteorologjinë;
th) hidrologjinë;
u) detet;
v) zonat ekologjike;
x) habitatet;
xh) shpërndarjen e specieve;
y) burimet energjetike;
z) burimet minerare.

3. Listës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni i shtohet çdo temë tjetër e përcaktuar, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet në fushën e informacionit gjeohapësinor dhe në përputhje me përparësitë e politikës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

Neni 12

Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore

1. Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore për secilën nga temat e përcaktuara nga neni 11 i këtij ligji, kryhen në përputhje me vendimet e ASIG-ut për secilën temë.

2. Në vendimin e ASIG-ut për secilën temë identifikohen autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përkatëse, si dhe përcaktohen afatet për mbledhjen e të dhënave dhe depozitimin e tyre pranë këtij autoriteti.

3. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të këtij neni, mbledhin, përpunojnë dhe përditësojnë të dhëna gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ASIG-ut, si dhe depozitojnë pranë këtij autoriteti të dhënat gjeohapësinore të mbledhura në afatin e përcaktuar prej tij.

4. ASIG-u, pasi të ketë marrë më parë mendimin e BIG-ut për përputhshmërinë e tyre me kërkesat/kushtet e përcaktuara, miraton ose refuzon përfshirjen në GIS-in Kombëtar të të dhënave të mbledhura në përputhje me këtë nen.

5. Vendimi i ASIG-ut për miratimin e të dhënave gjeohapësinore dhe përfshirjen e tyre në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, si dhe u komunikohet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

6. Vendimi i ASIG-u për refuzimin e përfshirjes së të dhënave gjeohapësinore në GIS-in Kombëtar shoqërohet me arsyetimin përkatës dhe u përcillet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, duke përcaktuar afatin, brenda të cilit këto autoritete duhet të adresojnë shkaqet e refuzimit, të sqaruara në arsyetimin e vendimit.

Neni 13
Metadatat

1. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin ose mbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, në bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadatat për këto të dhëna, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Metadatat përmbajnë informacion për:

a) përputhshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore me rregullat e ndërveprueshmërisë së grupeve të të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit;

b) kushtet në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, edhe për tarifat korresponduese;

c) cilësinë dhe vlefshmërinë e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;

ç) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;

d) kufizimet për aksesin publik dhe arsyet e këtyre kufizimeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji.

3. Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin e metadatave sigurojnë që metadatat të jenë të plota dhe në një cilësi të tillë që të plotësojnë qëllimin e përcaktuar në pikën 13 të nenit 3 të këtij ligji.

4. Rregulla më të hollësishme për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, për strukturën e katalogimit të metadatave, si dhe për afatet për krijimin e metadatave specifike për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministri, pasi të ketë marrë miratimin e BIG-ut dhe duke mbajtur në konsideratë standardet europiane ekzistuese për këtë qëllim dhe kërkesat për përdoruesit.

Neni 14
Ruajtja dhe arkivimi i të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave

1. ASIG-u është institucioni përgjegjës për përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, të cilat mbahen nga autoritetet publike përkatëse dhe ASIG-u.

2. Në përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave, ASIG-u mban në konsideratë legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Neni 15
Administrimi i të dhënave gjeohapësinore

1. ASIG-u është institucioni përgjegjës për administrimin e të dhënave gjeohapësinore të mbledhura, të përpunuara dhe të përditësuara nga autoritetet publike sipas nenit 12 të këtij ligji.

2. Të dhënat gjeohapësinore, të miratuara sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, integrohen në GIS-in Kombëtar dhe u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji për publikimin dhe përdorimin e tyre nga subjektet publike dhe private. Të dhënat gjeohapësinore të miratuara sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, mund të administrohen nga autoritetet publike që i prodhojnë ato vetëm për qëllime të realizimit të funksioneve të tyre publike.

3. Për grupet e të dhënave gjeohapësinore, për të cilat një palë e tretë gëzon të drejta të pronësisë intelektuale, autoriteti publik nuk mund të veprojë në zbatim të këtij ligji pa pëlqimin e kësaj pale.

Neni 16
Përcaktimi i standardeve dhe rregullave uniforme

1. ASIG-u është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e standardeve shtetërore dhe rregullave uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor, të cilat, pas marrjes së mendimit të BIG-ut, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Standardet shtetërore përfshijnë standardin e GIS-it Kombëtar dhe standardet shtetërore të sistemeve të informacionit gjeografik, sipas temave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, ose të miratuara nga ASIG-u.

3. Në përcaktimin e standardeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ASIG-u mban në konsideratë standardet europiane, të miratuara nga organizmat standardizues europianë.

4. Në rregullat uniforme përcaktohen hapat administrativë dhe teknikë që duhet të përmbushin autoritetet publike dhe subjektet private për krijimin e sistemeve të informacionit gjeografik.

Neni 17
Sistemet e informacionit gjeografik

1. ASIG-u është autoriteti përgjegjës për ngritjen e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji.

2. Autoritetet publike, të identifikuara sipas pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, janë përgjegjëse për ngritjen e sistemeve të informacionit gjeografik, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji.

3. Autoritetet publike depozitojnë menjëherë pranë ASIG-së sistemet e informacionit gjeografik, të krijuara sipas pikës 2 të këtij neni.

4. ASIG-u, pasi merr mendimin e BIG-ut për përputhshmërinë e tyre me standardet dhe rregullat uniforme të miratuara për sistemin përkatës, miraton ose jo sistemin e informacionit gjeografik dhe përfshirjen e tij në GIS-in Kombëtar.

5. Vendimi i ASIG-ut për miratimin e sistemit të informacionit gjeografik dhe përfshirjen e tij në GIS-in Kombëtar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar, si dhe i komunikohet me shkrim autoritetit publik përgjegjës, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

Neni 18
Ndërveprueshmëria

1. ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, merr masat e nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, për të dhënat gjeohapësinore ekzistuese dhe për ato që mblidhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe për metadatat korresponduese.

2. Me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë së grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, përcakton përkufizimin dhe klasifikimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me temat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, si dhe për mënyrën e gjeoreferencimit të këtyre të dhënave gjeohapësinore.

3. ASIG-u, në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse, harton rregulla të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë dhe, pasi të ketë marrë mendimin e BIG-ut, ia përcjell ato ministrit për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave. Këto rregulla duhet të përmbajnë parashikime edhe për aspektet e mëposhtme:

a) një kuadër të përbashkët për identifikimin unik të objekteve gjeohapësinore, identifikuesit e të cilëve mund të përcaktohen në hartë, me qëllim sigurimin e ndërveprueshmërisë midis tyre;

b) lidhjen midis objekteve gjeohapësinore;

c) atributet kryesore dhe sinonimet shumëgjuhëshe korresponduese;

ç) informacionin për dimensionin kohor të të dhënave;

d) përditësimet e të dhënave.

4. Rregullat për ndërveprueshmërinë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet:

a) të sigurojnë përputhshmërinë midis zërave të informacionit që i referohen së njëjtës vendndodhje ose të njëjtit objekt të paraqitur në shkallë të ndryshme;

b) të sigurojnë që informacioni i nxjerrë nga grupe të ndryshme të dhënash gjeohapësinore është i krahasueshëm për sa i përket aspekteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Çdo informacion i nevojshëm për përputhshmërinë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të miratuara në përputhje me këtë nen, përfshirë edhe të dhëna, kode dhe klasifikime teknike, u vihet në dispozicion autoriteteve publike dhe palëve të treta, sipas kushteve që nuk kufizojnë përdorimin e këtij infomacioni për këtë qëllim.

6. Për të siguruar përputhshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, që lidhen me një fenomen që shtrihet midis kufirit shqiptar dhe atij të një shteti tjetër, përshkrimi dhe vendndodhja e këtij fenomeni të përbashkët vendoset me pëlqimin e të dyja shteteve.

KREU IV
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE KOORDINIMI

Neni 19
Shkëmbimi i të dhënave gjeohapësinore

1. Autoritetet publike shkëmbejnë ndërmjet tyre grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, të miratuara nga ASIG-u, sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji, duke i garantuar njëri-tjetrit aksesin tek ato dhe përdorimin e tyre për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tyre publike.

2. Shkëmbimi i të dhënave, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kufizohet me vendim të ASIG-ut, në rastet kur prej tij rrezikohen proceset gjyqësore, siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Rregulla më të hollësishme për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, duke pasur në konsideratë nevojën e shmangies së kufizimeve që mund të krijojnë pengesa praktike për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, të cilat ndodhin në pikën e përdorimit.

Neni 20
Bashkërendimi ndërinstitucional

1. ASIG-u, në përputhje me përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji, bashkërendon veprimet dhe nismat e autoriteteve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor. ASIG-u siguron bashkërendimin ndërinstitucional për:

a) mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore;

b) përcaktimin e standardeve shtetërore dhe të rregullave uniforme;

c) investimet në sektorin e të dhënave gjeohapësinore.

2. Autoritetet publike i paraqesin ASIG-ut kërkesën për vlerësimin e çdo nisme në fushën e infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore, e cila përmban të dhëna teknike dhe financiare të plota, si dhe shoqërohet me dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.

3. ASIG-u, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas pikës 2 të këtij neni, i përcjell për mendim BIG-ut kërkesën e autoritetit publik dhe dokumentacionin teknik e financiar përkatës.

4. ASIG-u, pasi merr mendimin e BIG-ut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i përcjell autoritetit publik rekomandimin e tij të arsyetuar për nismën. Rekomandimi i ASIG-ut publikohet në Gjeoportalin Kombëtar.

Neni 21
Rekomandimi i ASIG-ut për nismat e autoriteteve publike

Në rekomandimin e ASIG-ut drejtuar autoritetit publik përfshihen:

a) sugjerime teknike dhe financiare për realizimin e nismës;

b) mendime për standardet dhe rregullat që duhet të zbatojë autoriteti publik;

c) të dhëna për autoritetet e tjera publike, të përfshira në këtë nismë;

ç) të dhëna për nisma dhe veprime që janë në proces zbatimi ose janë përfunduar e dorëzuar nga autoritete të tjera publike, të cilat duhen mbajtur parasysh gjatë procesit të zbatimit të nismës;

d) çdo rekomandim tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të nismës.

Neni 22
Bashkëpunimi me aktorë të tjerë

1. ASIG-u, përveçse me autoritetet publike, bashkëpunon ngushtë me sektorin privat dhe akademik, me qëllim krijimin e një baze të dhënash gjeohapësinore sa më gjithëpërfshirëse.

2. Autoritetet publike bashkëpunojnë ndërmjet tyre, por dhe me sektorin privat, për realizimin e nismave të përbashkëta, shkëmbimin e të dhënave gjeohapësinore të prodhuara prej tyre, zhvillimin e teknologjisë së gjeoinformacionit dhe pasurimin e bazës së të dhënave gjeohapësinore.

3. Për të siguruar bashkëpunimin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ASIG-u dhe autoritetet publike informojnë në mënyrë shkresore dhe/ose nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar subjektet private dhe akademike për nismat e ndërmarra prej tyre, në zbatim të këtij ligji, si dhe i ftojnë ata të marrin pjesë dhe të shprehin mendimin e tyre në mënyrë shkresore dhe/ose nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e ASIG-ut dhe/ose të BIG-ut, të organizuara për këtë qëllim.

KREU V
AKSESI TEK TË DHËNAT GJEOHAPËSINORE,
KUFIZIMET DHE KUSHTET

Neni 23
Shërbimet e rrjetit

1. ASIG-u vë në dispozicion të publikut të dhënat gjeohapësinore, për të cilat janë krijuar metadata, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përmes një rrjeti që ofron shërbime:

a) kërkimi, me anë të të cilave bëhet i mundur kërkimi i grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, në bazë të metadatave korresponduese dhe shfaqja e përmbajtjes së këtyre metadatave;

b) konsultimi, me anë të të cilave bëhen të mundur minimalisht shfaqja, lundrimi, zmadhimi apo zvogëlimi, shtresëzimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore që shfaqen dhe shfaqja e legjendës së informacionit dhe të çdo përmbajtjeje relevante të metadatave;

c) shkarkimi, me anë të të cilave mundësohet shkarkimi i kopjeve ose pjesëve të grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, aksesi i drejtpërdrejtë me to;

ç) transformimi, me anë të të cilave mundësohet transformimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore, me qëllim realizimin e ndërveprueshmërisë;

d) që lejojnë evokimin e shërbimeve për të dhënat gjeohapësinore.

2. Shërbimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ndërtohen duke mbajtur në konsideratë kërkesat që lidhen me përdoruesit, të cilat duhet të jenë lehtësisht të përdorshme, në dispozicion të publikut dhe të aksesueshme përmes internetit ose çdo mjeti tjetër të përshtatshëm telekomunikacioni.

3. Për shërbimin e parashikuar nga shkronja "a" e pikës 1 të këtij neni duhet të zbatohet minimalisht kombinimi i mëposhtëm i kritereve të kërkimit:

a) fjalët kyçe;

b) klasifikimi i të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve që lidhen me to;

c) cilësia dhe vlefshmëria e grupeve të të dhënave gjeohapësinore;

ç) shkalla e përputhshmërisë me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji;

d) vendndodhja gjeografike;

dh) kushtet, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore;

e) autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore.

4. Shërbimi i transformimit, i parashikuar nga shkronja "ç" e pikës 1 të këtij neni, duhet të kombinohet me shërbimet e tjera të parashikuara në po të njëjtën pikë, në mënyrë të tillë që të mundësohet vënia në veprim e këtyre shërbimeve, në përputhje me rregullat e ndërveprueshmërisë, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 24
Gjeoportali Kombëtar

1. Metadatat, të dhënat gjeohapësinore, grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga ky ligj, aksesohen përmes Gjeoportalit Kombëtar.

2. Gjeoportali Kombëtar ndërlidh shërbimet e katalogimit, shërbimet e hartografisë në web dhe shërbimet e rrjetit, të parashikuara nga neni 23 i këtij ligji, me shtresat tematike të krijuara për të dhënat gjeohapësinore për secilën nga temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

3. Gjeoportali Kombëtar krijohet, mirëmbahet, përditësohet dhe aksesohet nën kujdesin e ASIG-ut dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky autoritet.

4. ASIG-u, për krijimin e një vendi të sigurt për arkivimin dhe ruajtjen e informacionit të përfshirë në GIS-in Kombëtar, merr masat për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore në disa kopje, të cilat ruhen në ambiente të ndryshme dhe të rikuperimit nga katastrofa për Gjeoportalin Kombëtar.

Neni 25
Kufizimet

1. ASIG-u dhe autoritetet publike përkatëse kufizojnë aksesin publik te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e kërkimit, të përcaktuara nga shkronja "a" e pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur prej aksesit mund të rrezikohen siguria publike, mbrojtja kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare.

2. ASIG-u dhe autoritetet publike kufizojnë aksesin te grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për shërbimet e parashikuara nga shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, kur nga aksesi mund të cenohen:

a) konfidencialiteti i procedurave të autoriteteve publike, i parashikuar me ligj;

b) marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike ose mbrojtja kombëtare;

c) proceset gjyqësore, procesi i rregullt ligjor ose mundësia e autoriteteve publike për të kryer hetime penale ose administrative;

ç) konfidencialiteti i informacionit tregtar ose industrial, kur ai parashikohet nga legjislacioni shqiptar ose nga rregullat e një organizate ndërkombëtare, në të cilën Shqipëra është palë, për qëllime të mbrojtjes së interesave të ligjshëm me natyrë ekonomike, përfshirë edhe interesin publik në ruajtjen e konfidencialitetit statistikor dhe sekretin tatimor;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale;

dh) konfidencialiteti i të dhënave personale dhe/ose i dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky i fundit nuk ka dhënë pëlqimin për përhapjen e këtij informacioni, dhe kur konfidencialiteti në lidhje me këtë informacion parashikohet nga ligji;

e) interesat ose mbrojtja e çdo personi që ka ofruar vullnetarisht informacionin e kërkuar, pa qenë i detyruar ligjërisht ta bëjë një gjë të tillë, përveçse kur ky person ka dhënë pëlqimin për përhapjen e informacionit;

ë) mbrojtja e mjedisit, me të cilin lidhet informacioni, si vendndodhja e specieve të rralla.

3. Arsyet e kufizimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni vendosen duke mbajtur në konsideratë, rast pas rasti, interesin e publikut në përhapjen e informacionit dhe në interesin, të cilit i shërben kufizimi ose kushtëzimi i aksesit.

4. Aksesi te informacioni që lidhet me emetimet në mjedis nuk mund të kufizohet për shkaqet e parashikuara nga shkronjat “a”, “ç”, “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 të këtij neni.

5. Për kufizimet e parashikuara nga shkronja “dh” e pikës 2 të këtij neni zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Neni 26
Tarifimi

1. Shërbimi i kërkimit dhe i konsultimit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji, ofrohet falas nga ASIG-u.

2. Përjashtimisht pikës 1 të këtij neni, shërbimi i konsultimit i nënshtrohet pagesës së një tarife, në rast se vendosja e kësaj tarife justifikohet nga kostot veçanërisht të larta të krijimit dhe përditësimit të të dhënave gjeohapësinore të caktuara.

3. Shërbimet e tjera të ofruara nga ASIG-u i nënshtrohen pagesës së tarifave përkatëse.

4. Masa e tarifës për shërbim, rregullat për mënyrën dhe afatin e pagimit të tyre, si dhe kriteret e zbatimit të përjashtimit, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni për shërbimin e konsultimit, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27
Aktet nënligjore

1. Kryeministri, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 9 pika 2 dhe neni 10 pika 2 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktin nënligjor të parashikuar nga neni 6 pika 3 i këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga fillimi i veprimtarisë së ASIG-ut, miraton aktet nënligjore të parashikuara nga neni 13 pika 4, neni 16 pika 1, neni 18 pika 3 dhe neni 19 pika 3 të këtij ligji, në bazë të parimeve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

4. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për të dhënat gjeohapësinore, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor, të parashikuar nga neni 19 pika 3 e këtij ligji, miratojnë aktin nënligjor të

parashikuar nga neni 26 pika 4 i këtij ligji, në bazë të parimit të ofrimit të shërbimeve me cilësi përkundrejt kostove efektive.

5. ASIG-u, brenda 6 muajve nga fillimi i veprimtarisë së tij, miraton rregullat e parashikuara nga neni 24 pika 3 i këtij ligji.

Neni 28
Dispozitë kalimtare

1. Për temat e parashikuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat përkatëse krijohen brenda 5 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Të dhënat gjeohapësinore, të mbledhura, të ruajtura dhe të përditësuara nga autoritetet publike deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i përcillen ASIG-ut brenda afateve të përcaktuara nga ky i fundit për secilin autoritet, në varësi të përkatësisë tematike të të dhënave. Përpara përfshirjes së këtyre të dhënave në GIS-in Kombëtar, ASIG-u përcakton afate për autoritetet publike për përshtatjen e këtyre të dhënave me standardet shtetërore dhe rregullat uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor, të parashikuara në nenin 18 të këtij ligji.

Neni 29
Shfuqizime

Në nenin 4 pika 2, në nenin 5 pika 2 dhe në nenet 2, 6, 9, 12, 13, 14 dhe 16 të ligjit nr 8907, datë 6.6.2002 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë”, fjalët “si dhe është autori i ndërtimit dhe i mirëmbajtjes së rrjetit gjeodezik shtetëror”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.6.2012

Shpallur me dekretin nr.7721, datë 20.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 25.7.2012

PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MARRJEN E MASAVE TË MENJËHERSHME NDAJ SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË ZHURMË TEJ NORMAVE TË LEJUARA NË QENDRAT URBANE DHE ZONAT TURISTIKE E BREGDETARE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Krijimin e task-forcës në nivel qarku për marrjen e masave të menjëhershme për përballimin e situatës së krijuar nga ushtrimi i aktiviteteve ekonomike, që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane, zonat turistike dhe bregdetare.

Neni 2

1. Task-forca drejtohet nga prefekti i qarkut përkatës dhe ka në përbërje:
a) kryetarin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit në nivel qarku;
b) inspektorë të njësive inspektuese të Inspektoratit të Mjedisit në nivel qarku;
c) punonjës të shërbimeve të Policisë së Shtetit;
ç) inspektorë të policisë së bashkisë ose komunës, sipas juridikisonit territorial përkatës;
d) specialistë të Institutit të Shëndetit Publik dhe të strukturave vendore të shëndetit publik;
dh) përfaqësues të prefektit të qarkut;
e) inspektorë të Inspektoratit Shtetëror të Punës në nivel qarku.
2. Punonjësit e task-forcës zbatojnë detyrimet e caktuara nga legjislacioni i posaçëm dhe ky akt normativ.

Neni 3

1. Task-forca ushtron aktivitetin e saj në çdo ditë të javës, duke ndaluar ushtrimin pas orarit të lejuar të veprimtarive të subjekteve, fizike e juridike, të cilat janë burim zhurme, si dhe në rastet e njoftimit nga institucionet shtetërore apo komuniteti për tejkalim të normave të lejuara të nivelit të zhurmës në mjedis.
2. Për mjediset e hapura, orari i lejimit të veprimtarive për ditët e premte dhe të shtunë të jetë nga ora 19:00 deri në orën 24:00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19:00 deri në orën 23:30, sipas normave të lejuara të zhurmës, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
3. Për mjediset e mbyllura, veprimtaria lejohet duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në udhëzimin e përmendur në pikën 2 të këtij neni.

Neni 4

1. Strukturat e Policisë së Shtetit, si pjesë e task-forcës, mbështetin ushtrimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Mjedisit për ekzekutimin e vendimeve, për të cilat ligji i posaçëm parashikon dënime administrative plotësuese, pezullim të aktivitetit dhe sekuestrim të pajisjeve dhe impianteve të subjekteve, që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", dhe aktet ligjore në fuqi.
2. Në rastet kur subjektet kundërshtojnë ndërprerjen e aktivitetit, ekzekutimin e vendimeve të Inspektoratit të Mjedisit referuar pikës 1 të këtij neni, ose pengojnë kryerjen e matjes së zhurmës nga specialistët e Institutit të Shëndetit Publik, veprohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", si dhe për rastet kur veprimet e subjekteve përbëjnë vepër penale, materialet i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

Neni 5

Njësitë e inspektimit të Inspektoratit të Mjedisit në qarqe, strukturat ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore, strukturat vendore të shëndetit publik dhe Institutit të Shëndetit Publik, si dhe strukturat e Policisë së Shtetit, marrin masa të menjëhershme për zbatimin e kërkesave ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë akt normativ, duke bashkëpunuar dhe duke bashkërenduar punën për garantimin e qetësisë publike në këto zona.

Neni 6

Ngarkohen strukturat e Inspektoratit të Mjedisit, të Institutit të Shëndetit Publik, strukturat vendore të shëndetit publik, njësitë e qeverisjes vendore, prefektet e qarqeve dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 7

Moskryerja e detyrës së ngarkuar nga punonjësit e strukturave të përcaktuar në nenin 2 të aktit normativ, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

Neni 8

Pika 3.1. e vendimit nr.587, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike", shfuqizohet.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 445, datë 11.7.2012

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1996 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj të jetë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 121 (njëqind e njëzet e një) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr. 527, datë 20.7.2011 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.7.2012
Doli nga shtypi më 31.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë